

Për nivelin  
e parë

Besa Luzna  
Lush Culaj  
Muhamet Ahmeti-Metis

# KULTURA SHQIPTARE



EMRI DHE MBIEMRI:


KLASA

SHKOLLA

VENDI

SHTETI

dukgjini





Besa Luzha, Lush Culaj, Muhamet Ahmeti-Metis

# KULTURA SHQIPTARE

Fletore tematike  
për nivelin e parë

*duk<sup>ə</sup><sub>D</sub>gjini*



## **MINISTRIA E ARSIMIT, E SHKENCËS DHE E TEKNOLOGjisë E KOSOVËS**

### **TEKSTE MËSIMORE PËR SHKOLLËN SHQIPE TË MËSIMIT PLOTËSUES NË DIASPORË**

Autorë/e:

Besa Luzha, Hazir Mehmeti, Lush Culaj, Muhamet Ahmeti-Metis, Nexhat Maloku,  
Nexhmije Mehmetaj, Rifat Hamiti, Rizah Sheqiri, Shefkije Islamaj, Xhevat Syla.

Hartues të këtij teksti: Besa Luzha, Lush Culaj, Muhamet Ahmeti-Metis

Koordinatorë: Arif Demolli, Basil Schader, Nuhi Gashi

Projekti është mbështetur nga Shkolla e Lartë Pedagogjike e Cyrihut  
(Instituti IPE -International Projects in Education) dhe  
Fondi i Llotarisë i Cyrihut (Lotteriefonds des Kantons Zürich) në Zvicër.



# Përbajtja

Njësia mësimore	faqe
1. Ju njoftoj me .....	6
Shokët dhe shoqet e klasës .....	7
2. Bisedë familjare .....	8
Pushimet verore .....	9
3. Mikpritja shqiptare .....	10
Në tryezën e përbashkët .....	11
4. Vizita në Prishtinë .....	12
Në Muzeun e Kosovës .....	13
5. Bukuritë e Kosovës.....	14
Vendi im .....	15
6. Ftesë nga daja Ukë .....	16
Në dasmën e fshatit .....	17
7. Komunikojmë .....	18
Me shoqërinë tonë .....	19
8. Udhëtojmë .....	20
Nëpër Shqipërinë e bukur .....	21
9. Në bregdet .....	22
Në Durrës lojë e argëtim .....	23
10. Shëtitje nëpër Tiranë .....	24
Në Tiranë .....	25
11. Kujtojmë historinë .....	26
Në Krujën e Skënderbeut .....	27
12. Në fshat .....	28
Punë të ndryshme .....	29
13. Këndoymë e vallëzojmë .....	30
Muzika shqiptare .....	31
14. Qyteti i bukur i Shkupit .....	32
Vendlindja e Nënës Tereze .....	33
15. Për ditëlindjen e Timit .....	34
Lojë, këngë e tortë .....	35
16. Piknik .....	36
Në Liqenin e Batllavës .....	37
17. Tregimet e gjyshit Ujkan .....	38
Tregimi im .....	39
18. Kthimi në shtëpi .....	40
Bisedat në klasë për pushimet verore .....	41
19. Festojmë së bashku .....	42
Festat tona .....	43
20. Letër nga Lisa e Timi .....	44
Letra ime .....	45

## Tregimi për pushimet në atdhe

Një familje shqiptare, e cila jeton në një qytet të Evropës, ka shumë miq. Fëmijët e tyre (Alba e Genci) miqësohen me shumë shokë e shoqe. Ata janë shembull i mirë si në fqinjësi, ashtu edhe në shkollë.

Tregimi për një pushim te familjarët e Albës dhe të Gencit është interesant. Gjatë këtij udhëtimi fëmijët mësojnë, njohin e miqësohen më shumë. Lexojeni këtë libër për ta kuptuar këtë tregim.





# 1. Ju njoftoj me

## Familja ime

- Shkruaj emrat e familjes tände

tezja



daja



nëha



gjyshja



babai



gjyshi



halla



burri i  
hallës



vëllau



unë



motra



djali i  
hallës



Genci

Alba

Suzi

## Prezanto veten

Unë quhem \_\_\_\_\_

Prindërit e mi janë nga \_\_\_\_\_


Gjyshërit e mijetojnë në \_\_\_\_\_

Shëno shkurtesën  
(nofkën) tënde

Halla ime jeton në \_\_\_\_\_

# Shokët dhe shoqet e klasës

Klasa ime



Shoku im quhet \_\_\_\_\_

Shoqja ime quhet \_\_\_\_\_

## 2. Bisedë familjare

### Shiko e bisedo



Alba e Genci bisedojnë me prindërit e tyre për pushimet verore në vendlindje. Alba i luti prindërit që t'i ftonim Lisën dhe Timin në këtë udhëtim interesant. Të gjithë u pajtuan për këtë propozim të mirë.

Të nesërmen filluan përgatitjet për pushime.



# Pushimet verore

## Këndo

- Lisa e Timi, ndërkokë, morën leje nga familja e tyre për pushimet e shumëpritura në vendbanimet shqiptare.



R. Sheqiri  
K. Hysniu



Allergo

O sa je - mi st t'gë - zu - ar ba - llë lart shkojm' në pu - shi - me

Shkoll' e da - shur shko - lla i - me po të lë tash në vet - mi

sa na gë - zoi ky qer - shor të shkël - qy' - shëm ne po shkojm'

në shta-tor me for - ca 'tre - ja do të kthe-hem për - së - ri

nda - he - mi sot gjith - an - dej di - kush n'det di - kush në mal - si

mjaft' u lo-dhëm nën - të mu - aj tash na du - het pa - këz fres - ki

## ËPËRSHËNDETJE SHKOLLËS

## Detyra e projekte

Bisedo për pushimet, vizitat familjare, piknikun etj.  
Plotëso fjalitë e mëposhtme:

Unë dëshiroj të pushoj në \_\_\_\_\_ (shëno ku).

Mua më pëlqen më shumë:

Durrësi

Rugova

Ulqini

Ohri

(shëno një vend  ).

- Çka ju pëlqen të merrni në pushime?

Lojërat, \_\_\_\_\_ (shëno çka).

### 3. Mikpritja shqiptare

#### Shiko e bisedo



- Mirë se erdhët, të dashurit e mi! - u tha gjyshi fëmijëve, duke i përqafuar me radhë.

- Lisa e Timi janë shokët e klasës sonë. Me ta banojmë në një pallat, - i tha Genci gjyshit!

Të gjithë ishin të gjëzuar. U futën në veturën e gjyshit Ujkan. Ashtu arriten në shtëpinë e tij.

#### Vërteto e shëno



Alba e Genci te gjyshi në Ko \_\_\_\_\_.

Flamuri i Kosovës i ka:

pesë yje  , gjashtë yje  , tri yje  , (shëno përgjigjen e saktë)



Unë dëshiroj të udhëtoj në vendlindje me: (**rretho një**)



# Në tryezën e përbashkët

## Shiko e bisedo



Gjyshi Ujkan u shprehu mirëseardhje fëmijëve. Ai i ftoi në tryezën me ushqime tradicionale, duke i uruar: "Mirë se ju solli zoti! Bukë, kripë e zemër"!

Fëmijët e shikuan me habi. Ata nuk i kuptuan fjalët që dëgjuan.

Gjyshja Hanë ua shpjegoi fëmijëve domethënien e fjalëve.

Fëmijët u kënaqën me ushqimet e shijshme.

## Detyra e projekte

I Trego kuptimin e fjalëve: "Bukë, kripë e zemër".

I Shkruaje një fjali për mikpritjen tënde në vendlindje.

## 4. Vizita në Prishtinë

### Bisedo e mëso

Vizita e fëmijëve në sheshin "Nëna Tereze" në Prishtinë ishte një fillim i këndshëm.

Ata e vizituan shtatoren e Skënderbeut. Aty bënë shumë fotografi. Në anën tjetër të rrugës ishte Teatri Kombëtar. Aty fëmijët panë një shfaqje me kukulla.

### Atdheu


*Ç'pamje t'bukura ka vendi im,  
Male t'larta o me blerim.*

*Tra, la, la, tra la la  
Oh, sa bukur!*

*Sa kullota e bagëti,  
Çdo bregore, vresht' e ullinj.  
Tra la la, tra la la,  
Oh, sa bukur!*

*T'gjith' punojmë edhe dëfrejmë  
Më të bukur e bëjmë Atdheun.*

*Tra la la, tra la la  
Oh, sa bukur!*



G. Avrazi

3  
4

Ç'pa - mje t'bu - kra ka ven - di im ma - le t'lar - ta o me ble - rim

Tra, la. la, tra, la, la. Oh sa bu - ku - ri

B. Shehu  
R. Pasmaçiu


# Në Muzeun e Kosovës

Shiko e mëso



Detyra e projekte

Ngjyros lojën e kukullave.



## 5. Bukuritë e Kosovës

### Shiko e bisedo




Në Mirushë



Në Shtëpinë e Lidhjes së Prizrenit




Në Shpellën e Gadimes



Në Malet e Sharrit

# Vendi im

Dëgjo, këndo e mëso



Adem Kastrati: "Motiv nga fshati"

- Bisedo për pikturen "Motiv nga fshati".
- Pikturo në bllok një pamje fshati nga vendlindja.
- Mëso vargjet dhe ushtro t'i recitosh bukur.
- Lexo poezinë "Vendi im" dhe provo ta këndosh.

## VENDI IM

- 1 Sa pyje, male,  
Fusha me lule,  
Kroje t'argjedta  
Ka vendi im!
- 2 Burra vigana,  
Djem si petrita,  
Gra vasha t'bukura  
Ka vendi im.
- 3 Si za bilbili,  
Porsi val' deti  
Vjen gjuha shqipe  
E vendit tim!
- 4 Ku gjinden zanat?  
Ku gjinden trimat?  
Ku gjinden nanat?  
Si n'vendin tim?

Qamil Guranjaku

Të këndojmë

## Pyje male

(Q. Guranjaku)

Moderato

Musical score for 'Pyje male' in G major, 2/4 time. The score consists of three staves of music with lyrics written below each note. The first staff starts with 'Sa py - je ma - le, fu - shame lu - le, kro - je t'ar - gjen - d'ta'. The second staff continues with 'ka ven - di im. Bu - rra vi - ga - na, djemt' si pe -'. The third staff concludes with 'tri - ta, gra, va - sha t'bu - kra ka ven - di im.'

R. Rudi

## 6. Ftesë nga daja Ukë

Lexo ftesën



Me rastin e martesës së djalit tonë

BESNIKUT  
me  
DONIKËN



Ju ftojmë të merrni pjesë në dasmë.  
Dasma do të bëhet në restorant "Kalaja",  
më 1 qershor 2010, duke filluar në orën 11.00.  
Me dashuri, daja Ukë.

Bisedo e pastaj shkruaj për dasmat dhe fejesat

---

---

---

---

---

---

---

---

---

---

---

Kush s'ka për mik, s'ka as për vete!  
*Popullore*

# Në dasmën e fshatit

## Dëgjo e vallëzo



## Detyra e projekte



Cilat instrumente muzikore i ke dëgjuar?

---

Cilat instrumente popullore i njeh?

---

Shkruaji një ftesë shokut ose shoqes për një festë.

## 7. Komunikojmë

### Mëso e komuniko



Në mbrëmje fëmijët biseduan nëpërmjet internetit me shokët dhe shoqet e klasës.

- O Greta, këtu në Kosovë është shumë bukur! - tha Lisa.
- Kemi vizituar shumë vende të bukura. Po t'i dërgojmë disa fotografi,
- i shkroi Alba një shoqeje.

Genci e Timi bisedonin me Ardin dhe Laurën në Sarandë. Ata i ftuan të takoheshin pas dy ditëve në Durrës.

### Vërteto e shëno



A e përdorni internetin?

- Për çka e përdorni internetin më shumë?

Për lojëra?

Për mësim?

Për komunikim?

- Me çka komunikon më me dëshirë?

Me letra?

Me telefon?

Me e-mail?

# Me shoqërinë tonë

## Shiko e bisedo

Pse jemi të ndarë

Hape vallen shqipe  
atje n'Kalabri,  
më ngadalë nga Bujanoci  
gjer n'Maqedoni.

Të gëzojm' se ne e kemi  
mëmë Shqipërinë  
kudo n'botë që jemi shk'putur  
thërret me dashuri.

Ref: Ne fëmijët ...



## Kërko e shkruaj

Artin e skuqi



Kompjuteri.

Arta komunikoi me



Die \_\_\_\_.

Besa shëtit në



Pl \_\_\_\_.

Zgjimi lahet në



Pa \_\_\_\_ u.

## 8. Udhëtojmë

### Mëso e bisedo



Lisa, Timi, Alba, Genci dhe prindërit e tyre u nisën për në Durrës. Rrugës, ata bisedonin e këndonin. Kënaqeshin me pamjet e bukura të natyrës, fushat, grykat, malet...

- Sa të larta janë këto male! - tha Lisa e befasuar.
- Nëpër këto male kalon tuneli i Kalimashit.
- Sa i gjatë qenka ky tunel! - u habitën fëmijët.

Ndërkohë babai i Albës filloi të recitonte këto vargje:

#### O MALET E SHQIPËRISË

*O malet e Shqipërisë dhe ju o lisat e gjatë,  
Fushat e gjera me lule që ju kam ndërmend ditë e natë.*


*Ju bregore bukuroshe e ju lumenj të kulluar  
çuka, kodra, brinja, pllaja, gërxhe e ju pyje të gjelbëruar.  
Do këndoj bagëtinë, që mbani ju e ushqeni  
O vendhit e bekuar, ju mendjen ma dëfreni.*

*Ti, o Shqipëri, më ep nder, me ep emrin shqiptar,  
Zemrën ti ma gatove, plot me dëshirë dhe me zjarr...*

*Naim Frashëri*

# Nëpër Shqipërinë e bukur

## Shiko e bisedo



Alush  
Shima:  
“Fshati  
bregdetar”



“Syri  
i kaltër”  
në  
Sarandë

## Lumenjtë e vendit tim

Në lumenjtë e vendit tim

Vala e gjëzuar.

Fusha nga vrapon ajo

Tok' e begatuar.

Ref: Gargallon ...

A. Jegnej  
E. Basha

Allegretto

Në lu - menjt' e ve - ndit tim u - fët e ku - llu - ar,  
Ma - let nga ka - lojn' me vrap, py - je të gjel - b'ru - ar.  
Gur - ga - lloa e nuk po - shon fush' e plla - ja i fres - kon.  
U - jë i be - ku - ar ar' e dridh pra - ni - ar.

## Detyra e projekte

- Provo të vizatosh një pikturë dhe të shkruash një poezi për bukuritë e natyrës shqiptare

\_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_

## 9. Në bregdet

**Shiko e bisedo**



**Vërteto e shëno**

- Sipas këtij ilustrimi, trego çfarë po bëjnë fëmijët në plazh?

*Alba* \_\_\_\_\_.

*Timi* \_\_\_\_\_.

*Lisa* \_\_\_\_\_.

*Genci vrapon* \_\_\_\_\_.

# Në Durrës - lojë e argëtim

## Lexo e bisedo



Pas vendosjes në hotel, fëmijët dolën në plazh.

- Uaa, sa i pafund qenka ky plazh! - u befasua Timi.
- Ejani të notojmë të gjithë! - propozoi Lisa.
- Do të notojmë dhe do të luajmë me top, - tha Genci.
- Pas lojës, do të ndërtojmë një kala të madhe me rërë, - propozoi Alba.
- E si duket një kala e vërtetë? - pyeti Lisa.
- Në mbrëmje do ta vizitojmë kalanë e vjetër të Durrësit, - tha Agroni.

## Detyra e projekte

- Ndërtoni një kala me materiale të zgjedhura.

- Vizato kalanë e ëndrrave tuaja.



## 10. Shëtitje nëpër Tiranë

**Shiko e bisedo**



- Kjo është Tirana, kryeqyteti i Shqipërisë, - u tha fëmijëve Agroni. Ata u ndalën pranë monumentit të Skënderbeut.
  - Sot do ta kalojmë ditën duke e vizituar këtë qytet të bukur. Së pari do të shëtisim nëpër këtë shesh të bukur. Pastaj do t'i vizitojmë Muzeun Kombëtar, Bibliotekën Kombëtare dhe Galerinë e Arteve.
- Fëmijët u kënaqën gjatë këtyre vizitave.



Ilustrim i Agim Sulajt

## Në Tiranë

### Shiko e bisedo



Pas vizitave nëpër qytet, fëmijët drekuan në një restorant.  
Edhe topat e akulloreve me ngjyra ishin më shumë se freskim!

### Detyra e projekte

- Në hartën e Evropës shëno kryeqytetin e vendit ku jeton tash.



# 11. Kujtojmë historinë

## Kujto e mëso

Timi e Lisa mësuan shumë emra djemsh e vajzash.

- Ilir, Albë, Genc, Agron, Teutë, Arbër ... janë emra shqip, - shpjegoi babai i Albës.

- Emra të bukur, - thanë Timi e Lisa.

- Edhe emrat tuaj janë të bukur, - tha babai i Albës. - Çdo gjuhë e ka bukurinë e vet.



## Kënga e flamurit

Festive T. Daija

Ty fla - mur të' du - am shum' ti pér ne je nën' e bab'  
pér ty gja - kun der-dhim lum' o fla - mur i  
kuq me shkab' kë - nga jon' je - hon mbi  
dhe mbi qy - tet e fush' e mal pér fla -  
mu - rin e vér - tet' pér të shtrenj-tin i de - al

# Në Krujën e Skënderbeut

## Lexo e bisedo



Kruja është qyteti i Skënderbeut.

Skënderbeu ishte prijësi i Arbërisë.

Ai ishte udhëheqës i mençur dhe trim i madh.

Ai u bë i famshëm në tërë botën.

## Detyra e projekte

- Ngjyros shtatoren e Skënderbeut?



## 12. Në fshat

### Shiko e bisedo



Shkruazi numrat në vendet e duhura të kafshëve

- 1 Gjeli
- 2 Pulat
- 3 Delet

- 4 Kali
- 5 Lopa
- 6 Viçi

- 7 Gomari
- 8 Cjapi

# Punë të ndryshme

## Lexo e bisedo

Dikur populli ynë kishte traditë punimin e qilimave. Këta qilima punoheshin me vegje. Ata ishin shumë të bukur.

Veglat e punës ishin të thjeshta.



## Detyra e projekte

- Lexo dhe trego kuptimin e fjalëve të urta popullore:

“Puna asht nder, puna asht vlerë”.

“Puna e mirë t’i kënaq sytë”.

“Punëtorin e don gjithkush, e dembelin s’e don kërkush”.

“Puno, e mos ja shtrij dorën kërkuj”.

*Mblodhi: Destan Bajraktari*

## 13. Këndoymë e vallëzojmë

### Shiko e bisedo

Festivali i këngëve për fëmijë i mbledhi dhe i kënaqi ata me muzikë dhe vallëzim. Disa këngë ishin shumë të dashura. Ato u kënduan nga shumica e të pranishmëve. Nuk mungoi edhe vallëzimi i përbashkët!



Kënga jonë në festival

*Moderato*

*Muzika: Sandër Çefa*

U mblo - dhëm kok' më ko -      kë te kën -  
di - na në mal.      Dhe thu - rëm ne një  
kën - gë o për fes - ti - val.  
ka kën - ga pun' e      dhje - ta ka lo - dra  
lu - le shum'.      në kën - gën ton' të  
thjesh - të      gë - zi - mi der - dhet lum.

*Kënga jonë në festival*

*Mira ia nis një këngë,*

*Beni se ç'ia kthen.*

*Shokët i mbajnë iso,*

*Kënga rrotull vjen.*

*Ka kënga pun'...etj.*

# Muzika shqiptare

# Këndo e mëso

## *Asaman-o trandofili çelös*

*Në një bahçë  
me zymbyla  
ka dal vasha  
tuj shetit.*

*O qenka veshun  
me të bardha,  
zëri i saj  
porsi bilbil.*

*Zemra më gëzoi,  
kur ajo m'shikoi  
zemra m'u bë mal  
nga bukuri e saj.*



## **Asaman-o trandofili çelës**

A musical score for a single melodic line. The key signature is one sharp (F#). The time signature is common time (indicated by a 'C'). The vocal line consists of eighth-note patterns and rests, with lyrics written below the notes. The lyrics are: 'dhe vaj-za si lu - le pran - ve - rès kën - gën tén - de po dë - gjon.' A bracket labeled '1.' is positioned above the last four notes of the line.

Musical score for the second ending of 'Po deojon'. The score consists of two staves. The first staff begins with a treble clef, a key signature of one sharp, and a common time signature. It contains six measures of music, ending with a repeat sign and a double bar line. The lyrics 'Po deojon' are written below the notes. The second staff begins with a bass clef, a key signature of one sharp, and a common time signature. It contains five measures of music, ending with a common time signature. The lyrics 'A-ma-ni a-ma-ni sho-ke mos e nqa-ni' are written below the notes.

The musical notation consists of a single staff in G major with a common time signature. It features a series of eighth and sixteenth note patterns. The lyrics are: "se më gë-zoi xha - nin bu-ku-ri e sai bu - ku - ri e sai." Measure 1 starts with a sixteenth note followed by an eighth note, then a sixteenth note followed by an eighth note. Measure 2 starts with an eighth note followed by a sixteenth note, then an eighth note followed by a sixteenth note. Measure 3 starts with a sixteenth note followed by an eighth note, then a sixteenth note followed by an eighth note. Measure 4 starts with an eighth note followed by a sixteenth note, then an eighth note followed by a sixteenth note.

## Detyra e projekte

- Mëso për këngetarë dhe krijues të muzikës shqipe
  - Krijo albumin tënd

## 14. Qyteti i bukur i Shkupit

### Shiko e bisedo



Pamje  
nga  
Shkupi




Vizitorët kthehen nga Shqipëria në Kosovë. U ndalën në Shkup, që është kryeqytet i Maqedonisë. Fëmijët shëtitën buzë lumit Vardar. Kaluan nëpër urën e vjetër. E panë shtatoren e Skënderbeut.

- Sa mirë, Skënderbeu na shoqëron edhe në Shkup! - tha Timi.
- Po Tim, ashtu është, Skënderbeu na shoqëron në shumë vende të botës, - tha Agroni.

Vizitorët vazhduan drejt qytetit të vjetër.

*Ngjyrosni secilin me ngjyrë të caktuar.*



# Vendlindja e Nënës Tereze

## Lexo e bisedo



Fëmijët u ndalën para një pllakë metalit.

- Këtu ishte shtëpia ku ka lindur Gonxhe Bojaxhiu - Nëna Tereze,  
- lexoi Teuta.

Ajo u foli fëmijëve për figurën dhe veprat bëmirëse të Nënës Tereze.

- Çka di për Nënën Tereze?



Musa Kalaveshi:  
"Gonxhe për Gonxhen"

*Nënë Tereze, moj nënëz-o*

*Si p'llumbesh' shtegton në bot'  
ti bën mir' e ndihmon  
her si gonxhe, her' si hënë  
na jep gaz, ti, moj nënë, hej!*

*Që nga jugu në veri  
na i mbush zemrat dashuri  
nënëz - o, moj nënëz - o  
nën' Terez' moj nënëz - o.*



**NËNË TEREZE, MOJ NËNËZ - O**

M. Piperku

Si p'llumbesh' shtegton në bot'      cm  
ti bën mir' e ndihmon      cm  
her si gonxhe, her' si hënë      G  
na jep gaz, ti, moj nënë, hej!      cm  
  
Që nga jugu në veri      fm  
na i mbush zemrat dashuri      cm  
nënëz - o, moj nënëz - o      B  
nën' Terez' moj nënëz - o      cm  
  
da - shu - ri,      fm  
në - në - zo, moj      cm  
nën' Te - rez' moj      fm  
nën' Te - rez' moj      cm  
në - në - zo,      Es  
në - në - zo,      cm  
zol!      D.C. al Fine Poi Coda  
nën' Te - rez' moj      cm  
në - në - zo,      cm  
në - në - zo,      cm  
zol!

## 15. Për ditëlindjen e Timit

### Shiko e bisedo



Mysafirët u kthyen në Kosovë.

U përgatit një festë e veçantë. Ishte ditëlindja e tetë e Timit.


Teuta e shtroi tryezën me të gjithë të mirat. Lisa i solli pijet dhe një tortë të madhe. Agroni e rregulloi muzikën dhe vendosi ndriçime me ngjyra. Alba e Genci bisedonin për dhuratat. Ndërsa Timi u zgjua nga celulari i Lisës dhe dëgjoi një këngë të njohur:

- Shumë urime për ty ...

### Vërteto e shëno

Shëno përgjigjet dhe ngjyros figurat.

- Teuta e shtroi tryezën me \_\_\_\_\_



- Lisa i solli pijet dhe një \_\_\_\_\_



- Alba e Genci bisedonin për \_\_\_\_\_

# Lojë, këngë e tortë

## Lexo e bisedo



Kaluan disa çaste të paharruara me këngë, vallëzim e urime. Pastaj Timi u fryu tetë qirinjve dhe ndau një pjesë nga torta e stolisur. Të gjithë e përqafuan atë dhe i dhanë dhurata të bukura.

Një punim dore me Skënderbeun mbi kalë bëri që Timi të gëzohej shumë.

## Detyra e projekte

Trego për atmosferën në ditëlindjen e Timit dhe ditëlindje të tjera.

- Sot T \_\_\_\_\_ i mbush 8 vjet.

- Cila dhuratë e gëzoi më shumë Timin? \_\_\_\_\_

- Ditëlindja ime është më: \_\_\_\_\_

# 16. Piknik

## Shiko e bisedo

Liqeni i Batllavës



- Çfarë të bëjmë sot? - pyeti Agroni.
  - Luajmë me kokrra misri, - tha Timi.
  - Jo, më mirë është të dalim në qytet, - kundërshtoi Genci.
  - Pse të mos shkojmë në piknik? - pyeti Lisa.
  - Të shkojmë në Liqenin e Batllavës, - tha Agroni. - Aty do të kalojmë shumë mirë. Do të peshkojmë. Do të luajmë. Do të përgatisim drekë së bashku.
- Të gjithë brofën me gëzim dhe vrapuan të merrnin gjërat e nevojshme.

## Komento e ngjyros vizatimin



# Në Liqenin e Batllavës

## Lexo e bisedo



- Shih çfarë peshku të bukur kemi zënë! - u tha Timi Teutës dhe Lisës, të cilat e mbulonin flinë me saç.

- Hidheni në liqen, - tha Lisa me dhembshuri. - Le të rritet. Le ta gjëzojë jetën.

Peshku notoi me kënaqësi sërish në ujë.

Fëmijët e ndien veten të lehtësuar. Ata bënë një vepër të mirë.

## Detyra e projekte

- Përshkruaj dhe vizato një pamje nga pikniku.

## 17. Tregimet e gjyshit Ujkan

### Shiko e bisedo

Para se të flinin, fëmijët e përqafonin gjyshin Ujkan.

Sonte gjyshi i dashur kishte zgjedhur t'u rrëfente atyre ngjarje dhe tregime interesante nga e kaluara shqiptare.

Një nga tregimet ishte edhe ky:

#### GJERGJ ELEZ ALIA

*Një herë e një kohë jetonte një trim mbi trimat. Ai quhej Gjergj Elez Alia. Kishte nëntë vjet që lëngonte në shtrat me nëntë plagë. Plagët i kishte marrë nëpër luftëra për të mbrojtur atdheun nga pushtuesit e huaj. Mbi kokë i rrinte motra e tij që ia lante plagët me ujët e kroit dhe ia thante me flokët e saj. Një ditë, motra e Gjergjit ishte shumë e mërzitur.*

- Ç'të mërzit kaq shumë, moj motër? - e pyeti ai.

- O Gjergj, nga deti ka ardhur një Baloz i zi dhe kërkon nga çdo shtëpi një dash e një vashë. Nesër e ka radhën kulla jonë.

- Jo, - tha Gjergji, - unë nuk kam vdekur ende që të lë motrën në dorë të Balozit të zi.

*Gjergji e ftoi në duel Balozin. Balozi i zi, kur pa Gjergjin, nisi të tallej:*

- A nga varri je ngritur, o Gjergj Elez Alia?

- O Baloz, - ia ktheu Gjergji, - të parët tanë na kanë lënë një amanet:

*përpara se të japim pasurinë dhe motrën, të japim jetën në fushë të mejdavit. Prandaj ruaju...*

*Dhe Gjergji e hodhi fort topuzin e tij. Topuzi i Gjergjit këputi kokën e Balozit të zi. Topuzi u ngul 12 pashë nén dhe. Pluhuri u ngrit 12 pashë përpjetë.*

*Trupin e përpjua dheu. Nëntë vjet vendi mbajti erë të keqe.*

Legjendë shqiptare

#### Fjalorth

amanet - porosi

topuz - mjet luftë

pas - masë gjatësie

# Tregimi im

## Shiko e bisedo



Ismail Lulani: "Bajlozi i zi"

## Detyra e projekte

- Trego një përrallë për heronjtë e adhuruar.
- Shkruaj emrat e heronjve nga filmat.

Trimat dalin prej lufte e jo prej fjalëve  
*Popullore*

## 18. Kthimi në shtëpi

### Shiko e bisedo



Shëtitjet nëpër vende të ndryshme shqiptare përfunduan. Timi e Lisa u kthyen në shtëpinë e tyre. Ata kanë shumëçka për të treguar.

Fotografitë, gjërat që kanë blerë, dhuratat që kanë marrë do t'i ruajnë përjetë. Derisa Alba filloi t'ju tregonte prindërve të vet për rrugët e gjata dhe shëtitjet e këndshme, Timi e hapi dhuratën e tij të dashur dhe tha:

- Vetëm xha Agroni ka ditur t'më dhurojë diçka të tillë!

### Vërteto e shëno

- *Bisedo dhe shëno për pushimet e Lisës dhe të Timit.*

*Me kë ishin në pushime? \_\_\_\_\_*


*Kush e festoi ditëlindjen? \_\_\_\_\_*

*Cilat vende i vizituan ata? \_\_\_\_\_*

*Cilën dhuratë e pëlqeu më shumë Timi? \_\_\_\_\_*

# Bisedat në klasë për pushimet verore

## Lexo e bisedo



## Detyra e projekte

- *Bisedo dhe shëno përshtypjet e pushimit tënd të paharuar.*

---

---

---

---

---

*Ku do të pushonit vitin tjetër?* \_\_\_\_\_

## 19. Festojmë së bashku

**Shiko e bisedo**



Për ditën e shkollës u organizua një festë me program të pasur argëtues. Të gjithë nxënësit ishin të pranishëm në sallën e madhe për të ndjekur koncertin e të rinjve, grupin e valltarëve, grupin skenik, grupin e recitatorëve dhe galerinë e shkollës.


Programi u duartrokit nga nxënësit. Vallja e Shotës, e luajtur nga Alba, Timi, Lisa e Genci, u rikthye në skenë dy herë!

# Festat tona

## Bisedo e shëno



**FESTA  
FAMILJARE**



**FESTA  
FETARE**



**FESTA  
SHTETËRORE**

Në botë ka shumë festa. Dallojmë festa familjare, fetare e shtetërore. Këto festa janë të ndryshme dhe secila ka datën e vet.

## Detyra e projekte

*Pikturo në bllok një atmosferë festive.  
Shkruaj me pak fjalë një festë të dashur.*

## 20. Letër nga Lisa e Timi

Shiko e bisedo



Të nderuar miq, zonja Teutë e zoti Agron,

Ditë më parë, u kthyem në shtëpitë tona nga një pushim i paharruar. Ishin ato ditë të bukura për ne. Shpesh bisedojmë me prindërit tanë për rrugët e gjata, për lojën në plazh dhe për shtatoren në tri qytete. Në asnjë moment nuk e harrojmë mikpritjen bujare dhe flinë e shijshme. Vendlindja juaj ishte përplot me bukuri natyrore dhe kulturore. Tash kur ne i kemi filluar mësimet në shkollë, shpesh i shikojmë në hartë vendet që i vizituam. Tash ne mësojmë me kënaqësi, sepse duam të dimë edhe për shumë vende të tjera si vendi juaj.

Ju lutem, përshëndetni gjyshin Ujkan, dajën Ukë dhe të gjithë familjarët tuaj në atdhe.


Me shumë respekt,  
Lisa, Timi dhe familja ime.

# Letra ime

Shkruaj ti

Shkruaj për vizitat e tua më të mira.

Fotoja jonë







Nysret Salihmixhiqi  
“Loja”

Besa Luzha, Lush Culaj, Muhamet Ahmeti-Metis  
KULTURA SHQIPTARE  
Fletore tematike

Botimi i parë

Botues:  
*Shtëpia botuese "DUKAGJINI" - Pejë*

Për botuesin:  
*Agim Lluka*

Redaktor teknik:  
*Lavdim Beqiri*

Tirazhi: 5.000 kopje  
Formati: 205x285

U shtyp në shtator 2010  
në shtypshkronjën "Dukagjini" - Pejë  
[www.dukagjinigroup.com](http://www.dukagjinigroup.com)

Katalogimi në botim - (CIP)  
Biblioteka Kombëtare dhe Universitare e Kosovës

008(=18)(076.1)(075.2)

Luzha, Besa  
Fletore tematike: kultura shqiptare: për nivelin e parë 1-3/  
Besa Luzha, Lush Culaj, Muhamet Ahmeti. - Botimi 1.-Pejë:  
Dukagjini, 2010. - 48 f. ilustr. me ngjyra; 27 cm.

1. Culaj, Lush      2. Ahmeti, Muhamet-Metis

ISBN: 978-9951-05-233-7

Lejohet për botim me vendim të Ministrisë së Arsimit,  
të Shkencës dhe të Teknologjisë të Kosovës, nr 295/2, të datës 22.06.2010